

ANILA OMARI**PJETËR BOGDANI SI REGJISTRUES MBISHKRIMESH TË VJETRA:
NJË RELACION PAK I NJOHUR I VITIT 1658**

Jeta dhe veprimtaria e Pjetër Bogdanit është dokumentuar në një numër të madh dokumentesh e materialesh arkivore, në pjesën më të madhe të botuara. Botuesit kryesorë të dokumenteve ku përfshihet historia e Shqipërisë e shekujve XVII-XVIII dhe mes tyre edhe dokumentet që lidhen me Pjetër Bogdanin janë D. Coleti - F. Riceputi¹, Augustin Theiner², Jovan Radonić³, Injac Zamputi⁴, Marco Jačov⁵ etj., ndërsa në mënyrë të posaçme për mbledhjen e dokumentacionit lidhur me Pjetër Bogdanin kanë punuar Luigj Marlekaj⁶ dhe Odette Marquet⁷. Nga këto dokumente është rindërtuar në momentet më të rëndësishme të saj rrjedha jetësore e Bogdanit dhe veprimtaria e tij klerikale, intelektuale e politike, me përjashtim të periudhës së hershme të vendlindjes dhe datëlindjes si dhe të shkollimit fillor, të cilat ende sot nuk janë saktësuar përfundimisht. Për shkollimin e tij në kolegjet e Propaganda Fides dhe të Loretos kemi tani të dhënat dokumentare plotësuese të hetuara nga Bardhyl Demiraj në Arkivat e Kolegjit të Loretos dhe të Kolegjit Urban dhe të sjella në punimet e tij të kohëve të fundit mbi rishtarët shqiptarë në kolegjet italiane⁸.

¹ D. Farlati & J. Coleti, *Illyricum Sacrum*, VIII, Venetiis, 1819.

² A. Theiner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia*, Romae, Typis vaticanis, 1863-75.

³ J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd Naučna Knjiga 1950

⁴ I. Zamputi, S. Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699), ASHSH, IH, Tiranë, 1990.

⁵ M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vol. 1-2, Città del Vaticano: Biblioteca Apostolica Vaticana 1992.

⁶ L. Marlekaj, *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio Editrice, Palo del Colle (Bari), 1989.

⁷ O. Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës „de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*, At Gjergj Fishta, Shkodër, 1997.

⁸ B. Demiraj, “Rishtarë shqiptarë në kolegjin Ilirik të Loretos”, “Shëjzat” 3-4 [2016] 48-85, f. 22; Po ai, “Grimca biografike për autorët tanë të vjetër”, pj. III “Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit”, *Hylli i Dritës*, nr. 2, Shkodër, 2016, f.

Megjithatë vjeljet e dokumenteve burimore lidhur me jetën dhe veprën e Pjetër Bogdanit nuk mund të themi aspak se janë shteruar. Një burim i rëndësishëm dokumentesh pak ose aspak të hulumtuara është, për shembull, Arkivi shtetëror i Venedikut, por edhe arkivat e Raguzës, qoftë ata shtetërorë ose të urdhrave fetarë. Në këtë punim kemi sjellë në vëmendje një dokument të dorës së parë pak të njohur të Pjetër Bogdanit, i cili nuk është përfshirë në vëllimet me dokumente për shekujt XVI-XVII të botuara nga I. Zamputi. Është fjala për një relacion të një vizite kanonike të Pjetër Bogdanit në cilësinë e ipeshkvit të Shkodrës (zgjedhur në 6 mars 1656⁹) të cilën ai e ka kryer në vitet 1657-1658. Këtë relacion e ka botuar historiani Marco Jačov.¹⁰ Një relacion i Bogdanit për vizitën në Ipeshkvinë e Shkodrës mban edhe datën 1684, bashkë me dy relacione të tjera të tij të hartuara në kohë të ndryshme të cilat Bogdani ia ka paraqitur kardinalit Cibo me 24 mars 1684. Këto dokumente i ka botuar August Theiner dhe i ka përfshirë Injac Zamputi e Selami Pulaha në vëll. IV të “Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë”, vitet 1675-1699. Relacioni i parë nga këta të tre, ai për vizitën në Shkodër, mund të jetë hartuar në vitin 1658, siç del nga dokumentet e botuara nga Jaçovi. Nga krahasimi i të dy relacioneve, ai i botuar nga Jačov i 1658 dhe ai i botuar nga Zamputi e Pulaha del se nuk janë kopje identike e njëri-tjetrit por kanë disa ndryshime. Prandaj mund të themi se relacioni i botuar nga M. Jačov është pak i njohur nga studiuesit tanë dhe për këtë arsye m’u duk me interes ta përktheja në shqip.

Relacionet që bënin ipeshkvinjtë mbas vizitave të rregullta në dioqezat nën jurisdiksionin e tyre dhe që dërgoheshin në Selinë e Shenjtë kanë interes të madh për historinë e viseve që përshkruajnë, gjeografinë, etnografinë e tyre, përbërjen etnike e fetare të popullsisë si dhe për historinë e kishës katolike, përpjekjet e saj për të mbijetuar në kushtet e pushtimit osman, për të plotësuar mungesat në kuadrin kishtar e arsimin e tij e për shumë aspekte të tjera historike, sociale e kulturore që u japin këtyre dokumenteve një vlerë enciklopedike.

Edhe relacioni i Bogdanit mbas vizitës apostolike në Ipeshkvinë e Shkodrës në vitet 1657-1658 përmban shumë të dhëna të vlefshme që studiuesit e fushave të ndryshme mund t’i shfrytëzojnë për interesat e tyre studimore.

Para se të raportojë mbi veprimtarinë e tij apostolike, Bogdani bën një përshkrim të shkurtër të historisë dhe shtrirjes gjeografike të kësaj ipeshkvie, të

20-34. Shih tani edhe monografinë *Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX*, Onufri, 2017, f. 248-269.

⁹ L. Marlekaj, *Pjetër Bogdani dhe Shqipëria e kohës së tij*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f. 45.

¹⁰ M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, f. 6-14.

numrit të fshatrave të dy krahinave të mëdha të saj: Nënshkodrën dhe Mbishkodrën duke paraqitur edhe gjendjen ekonomiko-sociale dhe shpirtërore të popullsisë nën sundimin turk, kryengritjet e herëpashershme të malësorëve të nxitura ndonjëherë edhe nga vetë sanxhakbejlerët për qëllimet e tyre, presionet e ndryshme që bëheshin mbi klerin e krishterë dhe, në këtë kontekst, edhe qëllimin e vizitës së tij për të lehtësuar gjendjen e popullsisë së krishterë që përpiquej me shumë vështirësi të mbante fenë e vet të paprekur përballë presioneve të administratës dhe të bashkëkombasve tashmë të konvertuar në fenë myslimane.

Në vijim të relacionit ai përshkruan shërbesat dhe veprimtaritë e tjera kishtare që kreu gjatë kësaj vizite, fshatrat dhe kishat që vizitoi dhe gjendjen e tyre fizike, famullitarët dhe personalitetin e tyre, numrin e besimtarëve që morën shërbesat e tij dhe gjendjen shpirtërore të tyre.

Në këto përshkrime ipeshkvi i Shkodrës shfaq edhe kulturën e tij të gjerë dhe dituritë e tij në fusha të ndryshme, ku spikat vëmendja për monumentet kulturore e arkeologjike si dëshmi të historisë së vendit. Një vëmendje të veçantë ai i kushton kishës së Shën Shirgjit e Baftit në breg të Bunës, në të cilën ai kreu shërbesat fetare me datë 31 tetor 1656.

Për këtë kishë të famshme, e cila dokumentohet në burime të shumta mesjetare, ka pasur interesim të vazhdueshëm nga studiuesit. Një nga çështjet e diskutuara të kësaj kishe është koha e ndërtimit të saj. Një numër studiuesish mendojnë se ajo është ndërtuar në shekullin XIII mbi themelet e një manastiri më të vjetër të shekullit VI, por të tjerë e quajnë këtë pohim të mbështetur mbi të dhëna legjendare, të falsifikuara. Kolegu i Institutit të Arkeologjisë Gëzim Hoxha i ka kushtuar së fundi një studim pikërisht shpjegimit më të detajuar, me vështrime jo vetëm arkeologjike por ndërdisiplinore, të historisë së ndërtimit të kishës së Shirgjit. Duke shqyrtuar të dhënat arkeologjike, gjeografike, historike e epigrafike ai mendon se përmendja e një kishe të vjetër kushtuar shën Shirgjit e Baftit, në dorëshkrimin e Jetës së perandorit Justinian, të ndërtuar nga ky perandor në shek. VI, mund të lidhet me një kishë tjetër, jo atë të fshatit Shirgj, por të fshatit Velinaj në Oblikë, që në kohë më të vjetra ka qenë buzë Bunës, para se ky lumë të devijonte rrjedhën e tij aty ku është sot.¹¹ Një nga faktet më të rëndësishme ku mbështetet ky autor për ekzistencën e një kishe më të hershme se shekulli XIII është pikërisht mbishkrimi i kishës së Shirgjit i regjistruar për herë të parë nga Pjetër Bogdani gjatë vizitës së tij në këtë fshat.

Në relacionin e tij Bogdani ka transkriptuar mbishkrimin e fasadës së Kishës së Shirgjit, të lexuar nga shkronjat e gdhendura në mermer:

¹¹ Shih G. Hoxha, "A return to the history of the church of Sts. Sergius and Bacchus on the Buna riverbank", in: *New archeological discoveries in the albanian regions I*, Academy for Albanian Studies, Institute of Archeology, Tirana, 2017, ff. 625-722.

IN NOMINE DOMINI AMEN: EXIMIAE VIRGINIS FILIJ ANNO. DÑI. M.CC.XVIII- .MAGNIFICUS DÑUS: DÑUS UROSIUS DEI GRATIA RASIAE REX ILLUSTRIS, MAGNIFICI REGIS UROSIJ NATUS ... DÑAE ELENAE REGINAE. AEDIFICAVIT HANC ECCLIAM: IN HONOREM SANCTORUM MARTIRUM SERGIJ ET BACHI À FUNDAMENTIS USQUE AD FINEM STANTE ABBATE PETRO DOCNE SCUTTARENSI;

(In Nomine Domini. Amen. Eximiae Virginis Filii anno MCCXVIII, Magnificus Dominus Urosius Dei Gratia Rassiae Rex Illustris: Magnifici Reg; Urosii natus... Dominae Elenae Reginae Edificavit hanc Ecclesiam ad honorem S. S. M. M. Sergii et Bachi a Fundamentis. Usque ad finem: Stante Abate Petro Dioclen (Docne) Scutarensi.)

Në krahun e djathtë të kishës nga jashtë:

MEMENTO DÑE FAMULAE TUAE ELENAE REGINAE SERVIAE, DIOCLIAE, ALBANIAE CHILMIAE, DALMATIAE, ET MARITIMAE REGIONIS QUAE UNA CUM FILIJS SUIS REGIBUS UROSIO, ET STEFANO AEDIFICAVIT DE NOVO ISTAM ECLLIAM AD HÕREM BEATORUM MARTYRUM SERGIJ ET BACHI ET AD FINEM USQUE COM-
PLEVIT ANNO DÑI: M-CC-L-XXXX

(Kujto Zot shërbëtoren tënde Elenën mbretëreshë e Serbisë, Dioklesë, Shqipërisë, Zahlumjes, Dalmacisë dhe krahinave bregdetare e cila bashkë me djemtë e saj, mbretërit Urosh e Stefan ndërtoi përsëri (de novo) këtë kishë në nder të martirëve të lumë Sergji e Baku dhe e mbaroi deri në fund të vitit 1290).

Arkeologu G. Hoxha duke analizuar mbishkrimin thekson togfjalëshin *aedificavit de novo* “ndërtoi përsëri”, pra jo *ex novo* “nga e para”, që do të thotë se kisha ka pasë ekzistuar para vitit 1290. Mirëpo guri ku gjendet mbishkrimi, që sot gjendet në muzeun e Shkodrës, ka qenë dëmtuar pas vitit 1880 pikërisht në vendin ku ndodhej i gdhendur viti, dhe kjo ka sjellë lexime të ndryshme të datës nga studiuesit. Prandaj mbishkrimi i transkriptuar nga Bogdani mbetet edhe për kohën e sotme burimi më i besueshëm për kishën e Shirgjit. Relacioni i botuar nga M. Jačov që datohet në vitin 1658 është ai i hartuar nga Bogdani menjëherë mbas vizitës së tij apostolike në Shkodër dhe tregon edhe kohën e saktë të transkriptimit të mbishkrimit nga Bogdani. Studiuesit zakonisht mbajnë si datë të regjistrimit të mbishkrimit vitin 1684 të kopjes së dytë të relacionit që Bogdani mund t’ia ketë dërguar përsëri Selisë së Shenjtë ose thjeshtë të jetë lidhur bashkë me dy relacionet e tjera të tij të kohëve të ndryshme.

A RETURN TO THE HISTORY OF THE CHURCH OF STS. SERGIUS AND BACCHUS ON THE BUNA RIVERBANK




Fig. 5 Photos of two Shirqi's church inscriptions National Museum Tirana
b) Museum Shkodra

12

Dok. nr. 32613

Shkodër, 1658

Raport i ipeshkvit të Shkodrës Pjetër Bogdanit mbi vizitën e tij kanonike, zhvilluar gjatë viteve 1657 dhe 1658.

Përveç të dhënave për kishat, priftërinjtë dhe besimtarët, në raportin e tij ai ka sjellë edhe mbishkrimet e vjetra në kishën e Shën Shirqjit dhe Baftit, nga të cilat shihet se këtë kishë e ka ngritur nga themelet mbretëresha serbe Helena dhe djali i saj Uroshi.

Relacion për Shkodrën në Shqipëri

Qyteti shumë fisnik i Shkodrës, lehtësisht princeshë e Mbretërisë meqë ndodhet në kufijtë e Shqipërisë e të Dalmacisë, jo vetëm është pre e

¹² Foto e dy mbishkrimeve të Kishës së Shirqjit, marrë nga Muzeu Kombëtar i Toranës dhe Muzeu i Shkodrës, shih G. Hoxha, “A return to the history of the church of Sts. Sergius and Bacchus on the Buna riverbank”, art. i cituar, f. 701.

¹³ Dokumenti i botuar nga M. Jačov, në: M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, f. 6-14. Përkthimi im - A. Omari. Shënimet në fusnotat e tekstit të përkthyer janë gjithashtu të miat.

inkursioneve të vazhdueshme të barbarëve që zakonisht grabisin në zonat kufitare, por edhe për shkak shumëllojshmërisë së riteve që ushtrohen atje, të cilat, meqë është një qytet tregtar, janë të ndryshme, është në rrezik të vazhdueshëm për sa i përket çështjeve të fesë sonë të shenjtë.

U mor nga turqit rreth viteve të Krishtit 1478 dhe gjatë pushtimit të saj turqit shkatërruan një numër të madh kishash dhe të gjitha shtëpitë e priftërinjve duke tjetërsuar pronat me të gjitha ndërtesat kishtarë, dhe, duke vazhduar në cmirën shumë të madhe që kanë ndaj saj [d.m.th. Kishës], nuk lejojnë në asnjë mënyrë që të ndërtohen shtëpi për famullitarët [dhe kështu] priftërinjve dhe misionarëve u vjen mbarë të banojnë në shtëpitë private të shekullarëve, dhe për arsyet e mësipërme as Ipeshkvin nuk e lejojnë të ketë një vend të ngulur në dioqezën e tij, fatkeqësi që s'ka ndodhur me asnjë klerik tjetër të lartë në këto anë.

Për këtë arsye Imzotët paraardhës të mi, qoftë i lum kujtimi i tyre, për arsyet e mësipërme dhe meqë ishin me gjuhë dhe kombësi tjetër, asnjëherë nuk kanë mundur të qëndrojnë në kishën e tyre, duke i lejuar kjo Kongregatë e Shenjtë Imzotit të ndjerë Francesco Crutta që më të shumtën e kohës të qëndrojë në Budva me titullin e administratorit, ku merret vesh se ka bërë jo pak shpenzime për një strehë për pasardhësit e tij, të cilët i bindte që duhet ta pasonin në detyrën e administrimit meqë katedralja e tij nuk kishte një rezidencë.

I njëjti favor nuk iu mohua as të ndjerit Imzot Gregorio Fascina, i cili që nga krijimi i tij [si ipeshkëv] e deri në vdekje qëndroi në [vendet e] krishtërimit, aq sa popujt e varfër që unë i gjeta në një nevojë shumë të madhe shpirtërore rrëfejnë se nuk kanë parë një bari të vetin që prej 16 vjetësh.

Ipeshkvia e tij që shtrihet në gjatësi 60 milje dhe në gjerësi afro 10 milje, përfundon nga lindja në lumin Drin dhe ky e ndan nga Ipeshkvia e Sapës.

Nga perëndimi përfundon në Malin e Markotëve i cili e ndan nga Arqipeshkvia e Tivarit.

Nga jugu ndahet në kurrizin e Malit Basta, dhe [ky] e ndan nga një krah i Ipeshkvisë së Lezhës këtej Drinit në breg të Adriatikut.

Nga veriu ka për kufi një grumbull gurësh në majë të Malit Bishkashi, dhe [ai] e ndan nga Ipeshkvia e Pultit. Vendi pjesërisht është fushë shumë pjellore dhe quhet Nënshkodra, tërësisht e zotëruar nga turqit: pjesërisht janë male të quajtur Mbishkodra, disa prej të cilave nuk i nënshtrohen turkut.

Fusha e Nënshkodrës numëron 52 fshatra, gjithsej 1000 shtëpi katolike, të ndara në dymbëdhjetë famulli dhe 4 misione: janë shumë të varfër, por katolikë shumë të mirë dhe shumë të devotshëm ndaj Selisë së Shenjtë, frekuentojnë sakramentet e shenjta me zell të madh dhe, ndërsa janë besimtarët më të mirë të krishterë, mbahen edhe trimat më të mëdhenj dhe më të armatosurit e kësaj mbretërie.

Edhe Mbishkodra numëron rreth 600 shtëpi katolike të drejtuara nga vetëm dy priftërinj me rrezik jete, meqë malësorët i kërkojnë sakramentet e shenjta me forcën e armëve, megjithëse janë ngatërruar në një kaos çështjesh. Dhe disa nga këta malësorë shpesh herë ngrënë krye kundër turqve, duke dhënë shpesh shkas për kryengritje vetë sanxhakbejlerët, për t'i grabitur ose për të pasur shkak për të mos shkuar në luftëra të largëta, dhe për këtë arsye, ai [=sanxhakbeu] i Shkodrës, me pretekst për të mbrojtur qytetin dhe vendin nga ushtria e Venedikut dhe nga malet rebele të lartpërmendura, rri thujtë gjithmonë në Shkodër me dëm të madh të shtetasve të tij të krishterë.

Për këtë arsye ishte tepër e domosdoshme ardhja ime në këto kohëra të stuhishme për të lehtësuar popujt e varfër nga fatkeqësi të panumërta që përjetonin me të vetmin qëllim për të mbajtur fenë të paprekur midis të pabesëve; si rrjedhim, duke qenë shumë e nevojshme para se të nisja vizitën të paraqitesha tek Pashai dhe pushtetarë të tjerë të qytetit, qeshë i detyruar t'i qetësoja, me oficerët e tjerë turq. Pas kësaj fillova lirisht vizitën në datën 18 tetor ditën e Shën Lukë Evangjelistit të vitit 1656.

Dhe meqenëse në atë ditë festohet një panair madhështor në kishën e Shën Shirgjit dhe Baftit në breg të Bunës, i cili sipas një zakoni të vjetër mbahet njëmbëdhjetë ditë pas festës së martirëve të përmendur, m'u mohua prerë nga Pashai që të kryeja shërbesat në kishë për shkak të grumbullimit të madh të katolikëve të gatshëm për kryengritje, prandaj duke dalë kështu nevoja të kremtoja në atë ditë ceremonialisht në Dheun e Trumshit të sipërm me praninë e të gjithë priftërinjve dhe misionarëve, me pjesëmarrjen e popullit, nuk qe aspak më e pakët se ajo e panairit 3 milje larg.

Këtu pas shërbesave dhe predikimit që bëra unë, erdhën me zell të madh fetar për të marrë sakramentin e Konfirmimit të mëdhenj e të vegjël 212 vetë nga të dy gjinitë. Këtu ishte prift zoti Don Pjetër Trumshi, tani misionar në Shën Shirgj dhe më i zoti ndër të tjerët, zotëron gjuhën latine, italiane, shqipe e sllave, rreth 45 vjeç dhe i aftë të mbajë çfarëdolloj detyre kishtare. Veshjet [priftërore] i ka shumë të vjetra, me një kelshenjt prej kallaji.

Më 22 tetor të po atij viti vizitova fshatin e Kontit, një milje larg nga vendi i lartpërmendur, ku mbas meshës dhe një fjalimi frymëzues drejtuar popullit krezmova 37 vetë. Këta ishin nën kujdesin [shpirtëror] të Don Mark Kontit, i lindur në atë vend, burrë rreth 35 vjeç, me përvojë në funksionet kishtare, që u qëndronte pranë me kompetencë anëtarëve të famullisë së tij. Kremton në shtëpitë private meqenëse nuk ka as kishë as kapelë; veshjet e i ka shumë të thjeshta e të vjetra, me një kelshenjt dhe pjatë argjendi.

Me datë 24 të po këtij muaji vizitova Trumshin e poshtëm, ku edhe këtu, meqë turqit nuk lejojnë as kishë as kapelë, kremtova në shtëpi private, dhe pas fjalimit të zakonshëm frymëzues ndaj popullit krezmova 25 vetë. Këtu është famullitar zoti Don Giacomo Colomsa, njeri i mirë rreth 50 vjeç, ushtron detyrën e tij me shumë takt; ka kelshenjtin dhe pjatën e argjendit dhe një palë

rroba të vetat meqë fshati nuk ka mundësi që t'ia sigurojë vetë ato, dhe m'u lutën shumë që t'i shpreh Kongregatës së Shenjtë pamjaftueshmërinë e tyre për të mbajtur priftin, dhe me të vërtetë do të ishte një bamirësi e madhe e Hirësive Tuaja nëse do të denjoheshin t'i ndihmonin me njëzet skuda në vit për priftin, të cilin mezi e mbaj me shpresë në këtë kohë luftërash e murtaje, e cila është përhapur në pjesën më të madhe të kësaj dioqeze.

Me datë 25 të këtij muaji vizitova Barbullushin dhe kremtova në kishën e Shën Shtjefnit [që është] shumë e vjetër dhe ka një kambanore shumë të bukur; këtu, mbas bekimit të varreve dhe mbas një fjalimi frymëzues si zakonisht krezmova 98 vetë. Këtu ishin priftërinj zoti Don Demetrio Giuddura, dhe Don Theodoro Summa, të cilët mund të shërbejnë në nevojë të skajshme, të shuguruar nga i ndjeri Imzot Benedetto Ursini ipeshkëv i Lezhës.

Me 29 të këtij muaji vizitova fshatin e quajtur Caposerpente [Kryegjarpën], kremtova në kishën e Shën Gjergjit ku pas bekimit të varreve dhe fjalimit të zakonshëm frymëzues drejtuar popullit krezmova 71 vetë. Këtu është famullitar Don Nicolò Grubessa që nuk e ka shumë frikën e Zotit, pasi pretendon të zgjerojë famullinë e tij në dëm të të tretit, me ndihmën e Pashait, mikut të tij të ngushtë, për shkak të marrëveshjeve të fshehta që ka me të [për të mësuar] se çfarë ndodh ndër klerin dhe katolikët, dhe [Pashai] ma ka rekomanduar shumë herë me gjithë ndalimet e mëdha dhe censurat kishtarë që unë kam bërë kundër atyre që kërkojnë ndihmën turke për të marrë famulli dhe përfitime të tjera kishtarë.

Me datën 31 të këtij muaji vizitova fshatin e quajtur Shën Shirgj, ku pas shërbesës si zakonisht krezmova 46 vetë, dhe meqenëse ishin ankuar për mungesën e priftërinjve, dhe kishin vdekur disa njerëz pa sakramentet e shenjta, me urdhër të Kongregatës së Shenjtë u ngarkua si misionar zoti Don Pietro Trumsci, kur përkujdesja e tij e parë mund të ishte bërë nga priftërinjtë Don Giacomo Colomsa dhe Don Marco de Conti. Këtu ndodhet kisha madhështore e shenjtëve martirë Shirgji e Bafti, e gjatë rreth 50 pash, e gjerë njëzet dhe po aq kut e lartë, dhe është e famshme për tre varret e mbretërve të Shqipërisë¹⁴.

¹⁴ Mbretër serbë që kanë sunduar në Diokle (Mal të Zi) e në Shqipërinë e Veriut. Në Kronikën e priftit të Dioklesë, gjithsesi e kontestuar për vërtetësinë e saj, thuhet se në kishën e Shirgjit dhe Baftit janë varrosur disa anëtarë të dinastisë së Vojslavljevićëve të Dukljes (Dioklesë), si Mihali I, Konstandin Bodini, Dobroslavi, Vladimiri dhe Draginja. Khs. *Prilozhi za književnost, jezik, istoriju i folklor*, 51-52, Državna Štamparija, 1988, f. 94, në: Shirgj Church në Wikipedia (https://en.wikipedia.org/wiki/Shirgj_Church, shën. 3); shih dhe A. Ndreca, "Rrënojat e abacisë së Shirgjit dhe shpëtimi i tyne", me citim të M. Orbinit, në *Gazeta 55*, 15.9.2008 (<http://gazeta55.al/rrënojat-e-abacise-se-shirgjit-dhe-shpëtimi-i-tyne>).

Ka një kambanore shumë të bukur, që nga lartësia e saj zbulon gjithë vendin. Mbahet për traditë që kambanat të jenë varrosur midis Kishës kryesore të përmendur dhe kishëzës së Shënnaprendës (Santa Veneranda) një çerek milje larg dhe thuhet edhe se atje janë varrosur sasi të mëdha argjendurinash të kishës, të cilat nuk janë mundur të tërhiqen kur vendi u pushtua.

Aty pranë janë gërmadhat e manastirit të fretërve benediktinë që asokohe drejtonin kishën; ka titullin e abacisë, dhe thuhet se ka pasur 16 mijë talerë të ardhura në vit, kurse tani vendi është shumë i varfër meqenëse turqit kanë uzurpuar të gjitha pronat.

Në fasadë ka të gdhendura në mermer me shkronja të vjetra këto fjalë:

IN NOMINE DOMINI AMEN: EXIMIAE VIRGINIS FILIJ ANNO. DÑI. M.CC.XVIII- .MAGNIFICUS DÑUS: DÑUS UROSIUS DEI GRATIA RASIAE REX ILLUSTRIS, MAGNIFICI REGIS UROSIJ NATUS ... DÑAE ELENAE REGINAE. AEDIFICAVIT HANC ECCLIAM: IN HONOREM SANCTORUM MARTIRUM SERGIJ ET BACHI À FUNDAMENTIS USQUE AD FINEM STANTE ABBATE PETRO DOCNE SCUTTARENSI;

Në krahun e djathtë të kishës nga jashtë:

MEMENTO DÑE FAMULAE TUAE ELENAE REGINAE SERVIAE, DIOCLIAE, ALBANIAE CHILMIAE, DALMATIAE, ET MARITIMAE REGIONIS QUAE UNA CUM FILIJS SUIS REGIBUS UROSIO, ET STEFANO AEDIFICAVIT DE NOVO ISTAM ECLĪAM AD HÕREM BEATORUM MARTYRUM SERGIJ ET BACHI ET AD FINEM USQUE COM-
PLEVIT ANNO DÑI: M-CC-L-XXXX ¹⁵

Mbasi bëra kremtimet ceremoniale në 1 nëntor në kishën e mësipërme, në datën 2 të këtij muaji vajta të vizitovj famullinë e Shën Nikollës mbi malin në breg të Bunës dhe pas shërbesave të zakonshme krezmova 152 vetë. Kisha ka një shtrojë zbulimi me një kelshenjt argjendi, dhe meqenëse vendi është shumë i varfër, famullitari i tyre ndihmohet nga mëshira e Kongregatës së Shenjtë, dhe Don Pjetër Dajçi, njeri i mirë dhe njohës i Shkrimeve të Shenjta shërben me miratim të veçantë të popullit dhe të eprorit të tij.

Në datën 4 të këtij muaji vizitova famullinë e Shën Nikollës në bregdet ku derdhet Buna, dhe mbas shërbesave të zakonshme krezmova 290 vetë, të cilët ishin nën kujdesin shpirtëror të Don Mark Gjinit, njeri shumë injorant i shuguruar nga i ndjeri Imzot Benedetto Ursini ish ipeshkëv i Lezhës.

¹⁵ Marko Jačov, *Spisi Tajnog vaticanskog arhiva XVI – XVIII veka*, Beograd 1983, 135.

Në datën 8 të këtij muaji vizitova fshatin e Shën Gjergjit përsëri në breg të Bunës, ku mbas shërbesave të zakonshme krezmova 150 vetë. Këtu është famullitar Don Tomas Harmanni me prejardhje fisnike, rreth 45 vjeç, shumë për së mbari dhe i devotshëm ndaj eprorit të tij.

Në pesë ditët në vijim vizitova Fshkashin, Braiskën, Midën dhe Selitën; këto vende ndodhen në drejtim të Markotëve skizmatikë; dhe meqenëse janë në kufi, shumë nga të lartpërmendurit erdhën në predikimin tim dhe vërtet kjo vizitë qe me një frytshmëri shumë të madhe shpirtërore. Këtu Ipeshkvia e Shkodrës kufizon me atë të Tivarit, dhe mbasi predikova dhe kremtova në secilin nga dy vendet e lartpërmendura, më në fund në kishën madhështore të Zonjës të ndërtuar në vitin 1214 në Fshkash u krezmuan 207 vetë. Këta janë nën kujdesin shpirtëtor të Don Gjini Troshanit, i lindur në Sapë, me përvojë në punët kishtarë. Famullia e mësipërme e Fshkashit ka një palë shtroja zbukuroese dhe një kelshenjt të vogël dhe pjatë.

Në datën 16 vizitova famullinë e Samrishit në breg të Bunës, kremtova në kishën e Shën Gjoni Pagëzuesit dhe mbas shërbesave të zakonshme krezmova 137 vetë. Ky vend ka si kishë kryesore kishën e Lindjes së Zonjës të pajisur mirë me shtroja zbukuroese dhe kelshenjta. Famullitari i saj është Don Stefano Bobolti, njeri me arsim të mirë dhe i mirëdashur nga shtetasit e tij.

Në datën 17 të këtij muaji vizitova Obotin, kremtova në kishën e Shën Baftit këtej Bunës përballë Shën Shirgjit dhe pas predikimit dhe shërbesave të zakonshme krezmova 58 vetë. Këtu është misionar Don Giovanni Tochesi [Gjon Tokëzi] njeri shembullor [i cili] me zell të veçantë predikon në gjuhën shqipe dhe kujdeset për detyrën e tij.

Në datën 19 të këtij muaji vizitova dheun e Shirokës [ku] kremtova në kishën e Shën Mari Madalenës dhe krezmova 141 vetë; ky vend, ngaqë është ngjitur me qytetin, pëson shumë fyerje nga turqit; këtu mëshira e Kongregatës së Shenjtë mban si misionar Don Antonio Vladanjin, ekspert në kremtimet kishtarë.

Në vendin e mësipërm mori pjesë dheu i Kishanjit [Kishaj], ku donte të futej si misionar Don Mark Ufa, por meqë gjeta si famullitar [atje] Don Primo Samrishin, e konfirmova në detyrën [shpirtërore] që kishte, duke u kënaqur [ai] që të shërbente pa asnjë interes sipas mundësisë reale.

Me 21 të këtij muaji, i veshur tebdil, vizitova katolikët e qytetit të Shkodrës, dhe meqë nuk munda në asnjë mënyrë të kremtoja shërbesat, nuk desha të lija të paktën pa shënuar antikitetet e mëposhtme:

Në hyrjen mbi portën e parë të dajlanit pranë Banjës gjendeshin shënimet vijuese:

M.CCCC.LXXV°:IV°:OCT:

Në Xhaminë e re pranë Urës së thyer në një gur katërkëndësh gjenden mbishkrimet si më poshtë:

IMP.CAE
E.SEPTIM°.
SEVER.O.PER
TINACIA.UG
TR.P.IN.MD
III.COST.
PP.DD.¹⁶

Në Xhaminë e kështjellës, më parë kishë e Shën Shtjefnit Pajtor, është një organo shumë i bukur i prishur, të cilin barbarët e lejojnë që të ruhet si trofe i sipërmarrjeve të tyre. Dhe këtu i dhashë fund vizitës së vitit të lartpërmendur 1656 meqenëse erdhi dimri, i cili është shumë i ashpër për shkak të borës dhe përmytjeve të dy lumenjve kryesorë, Drinit dhe Bunës.

Numri i të gjithë të krezmuarve të vitit të lartpërmendur është 1614, emrat e të cilëve nuk mund t'i shënoj për të mos u dhënë shkas për dyshim turqve, të cilët me ndalesa të tmerrshme më kanë ndaluar t'i shkruaj.

Për shkak të varfërisë së tij, vendi nuk ka zakon të japë qirinj siç është zakon në Krishterim [të jepen] lëmoshë të tjera për [sakramentin e] Konfirmimit.

Viti 1657

Në kohën e kreshmëve të mëdha të këtij viti të gjitha vendet e sipërthëna u vizituan përsëri prej meje, duke predikuar personalisht në secilën nga famullitë e lartpërmendura; dhe mbasi bëra shugurimin e vajit të shenjtë dhe mbasi përfundova shërbesën e Rrëshajave dhe Corpus Domini-n, më 27 qershor të këtij viti shkova në fshatin Keselena ku mbas meshës dhe predikimit krezmova 28 vetë. Këta bëjnë pjesë në famullinë e Fshkashit, siç u shënu vitin e kaluar.

Më 2 korrik qeshë në Barbullush, ku mbas meshës dhe fjalimit frymëzues ndaj popullit krezmova 85 vetë, të cilët nuk arritën të krezmoheshin vitin e kaluar.

Më 10 korrik vizitova famullinë e Sheldisë, kremtova në kishën e Shën Jeronimit, dhe mbas shërbesave të zakonshme krezmova 70 vetë. Këtu është famullitar Don Aleksandër Sheldia fetar shumë i mirë; ky vend është caku i fundit drejt Ipeshkvisë së Sapës.

¹⁶ Ibid.

Mbasi plotësova Sakramentin e Krezmimit për gjithë Nënshkodrën, u tërhoqa në Trumsh tre milje larg nga qyteti. Ky vend është një feud, ose tokë e dhënë në pronësi nga Sulltani shtëpisë së Isuf Begut, më i fuqishmi i kësaj mbretërie. Ky është vendi më i sigurt për të qëndruar Ipeshkvi duke mos njohur tjetër sundimtar në vend veç këtij të lartpërmendurit dhe do të isha përpjekur të bëja njëfarë shtëpie për të banuar, por meqë turku ka zakon të mos respektojë vullnetet e fundit [=amanetet], në mënyrë që të mos lejojë njerëzit e fesë të qëndrojnë në një vend të ngulur në territorin e qytetit, katolikët ma ndërruan mendjen, duke qenë të sigurt se pas vdekjes [sime] gjithçka që do të bëhej [=ndërtohej] do t'i shkonte financave të shtetit, siç kishte ndodhur me trashëgimitë e tjera bamirëse kur u pushtua qyteti.

Numri i të krezmuarve këtë vit është 183.

Viti 1658

Edhe këtë vit përsërita vizitën në kohën e kreshmëve të mëdha duke parë nevojën e madhe për predikime. Në secilën prej famullive shpalla faljen e plotë, në përputhje me fuqitë që më ka dhënë Zotynë me ndërhyrjen e kësaj Kongregate të Shenjtë, u përpoqa sa qe e mundur që të gjithë të marrin thesarin shpirtëror i cili për shumë kohë u ka munguar, ngaqë nuk kishte kush të thyente bukën¹⁷.

Gjatë praktikave shpirtërore të përmendura u zbuluan shumë vese, sidomos [tek] disa që në mënyrë të fshehtë kishin lidhur [martesë] dhe kishin jetuar pa Sakramentet e Shenjta për më shumë se 16 vjet duke lindur fëmijë, por që kuptuan nga fjalimet frymëzuese dhe predikimet se kjo ishte në dëm të shpirtave të tyre; duke u lidhur [në martesë] faqe kishës, të gjithë u pajtuan, mbasi unë shpalla të ligjshëm fëmijët e tyre sipas fuqive të përmendura më lart.

